



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 311

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË DISA
INSTITUCIONEVE, PËR PERIUdhËN 24 MARS – 30 MARS 2023**

Sot, më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale IDP, Prefekti i Qarkut Shkodër, Bashkia Tiranë, Bashkia Korçë, Bashkia Kurbin, Bashkia Tepelenë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Pogradec.

OBJEKTI: Vlerësim i veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 24 mars deri më 30 mars 2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 12.4.2023 Nr: 311
Ora: 12:00



“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 24 Mars - 30 Mars 2023”

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 24 mars deri më 30 mars 2023, në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike, janë raportuar gjithsej 353 aktivitete nga 67 institucione. Nga verifikimi paraprak rezulton se 16 aktivitete të zhvilluara nga 11 institucione janë raportuar në tejkalim të afatit ligjor. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka kryer shqyrtimin administrativ si vijon;

1. **Ministria e Financës dhe Ekonomisë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 - Aktivitet *“Konferencë mbi prezantimin e Programit IADSA”*, raportuar në datë 27.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve dhe nga rrethanat dhe faktet, vlerëson se nisur nga natyra dhe përmasat që ka ky aktivitet, pjesëmarrja e partnerëve të huaj Ambasadori Gjerman, Drejtoresha e Agjencisë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim si dhe fakti që nuk është i hapur për publikun, nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

2. **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
 1. Aktivitet *“Ftesë për pjesëmarrje në takim që do të zhvillohet me rastin e pranisë në Vlorë të ‘‘PUPO’’*, raportuar në datë 27.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 29.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve, rezulton se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

3. **Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Forum biznesi, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në kuadër të fushës së vetë të veprimtarisë do të marrë pjesë në aktivitetin që do të zhvillohet nga Dhoma Italiane e Biznesit në Shqipëri”*, raportuar në datë 24.03.2023 për t’u zhvilluar në datë 28.03.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve rezulton se Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

4. **Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet *“Takim dypalësh me Delagacionin e Austrisë, Ministri i Jashtëm”*, raportuar në datë 25.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve dhe nga rrethanat dhe faktet, rezulton se Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka njoftuar nëpërmjet email – it datë 27.3.2023 se ky aktivitet nuk është zhvilluar. Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se nuk jemi para kundërvajtjes administrative për aq sa aktiviteti nuk është zhvilluar.

5. **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale IDP** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Mbrojtja e të dhënave personale në sektorin e pasurive të paluajtshme, në një pikë grumbullimi drithërash”*, raportuar në datë 29.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në raportim të ndërfaqes dhe nga rrethanat dhe faktet, rezulton se Komisioneri për të Drejtën e Informimit

dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale IDP ka sqaruar nëpërmjet email – it datë 29.3.2023 se *“ju bëjmë me dije se jemi të informuar në lidhje me detyrimin për raportimin zhvillimit të aktiviteteve pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 5 ditë para organizimit të tyre. Megjithatë, sqarojmë se ky aktivitet kryhet në kuadër të një projekti, financuar nga Ambasada Zviceriane në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për një Zhvillim të Qëndrueshëm (ASDO), ku si pjesë e projektit është parashikuar zhvillimi i një serie tryezash informuese në lidhje me ndërgjegjësimin e kontrolluesve që kryejnë veprimtari përpunuese në sektorë të ndryshëm. Qëllimi është njohja e tyre me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Në kushtet kur, për finalizimin e agjendës së këtij aktiviteti është dashur të koordinohet dhe merrej konfirmimi edhe i përfaqësuesve të partnerëve të sipërcituar, si dhe i të gjithë përfaqësuesve të sektorit të pasurive të paluajtshme që priten të jenë prezent në takim, raportimi për zhvillimin e tij u krye ditën e sotme. Ndër të tjera, sqarojmë se ky aktivitet nuk ka prezencë të medias, por është një aktivitet në nivel teknik, ku përfaqësuesit e sektorit të pasurive të paluajtshme (në cilësinë e kontrolluesve) do të marrin informacion mbi detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”*

Në këto kushte, nisur nga natyra dhe përmasat që ka ky aktivitet, financimi i tij nga Ambasada Zviceriane dhe pjesëmarrja e domosdoshme e partnerëve të huaj (vështirësia e organizimit/koordinimit të tyre lidhur me datën e zhvillimit të aktivitetit), Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale IDP nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet.

6. **Prefekti i Qarkut Shkodër** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Mbledhja e rradhës së Këshillit të Bazetit Ujëmbledhës Drin Buna”*, raportuar në datë 30.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 6.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në raportim të ndërfaqes dhe nga rrethanat dhe faktet, rezulton se Prefekti i Qarkut Shkodër ka sqaruar nëpërmjet email – it datë 3.4.2023, se *“Nga ana jonë është bërë një lapsus në hedhjen e të dhënave. Takimi do të zhvillohet në datë 6.4.2023 (dhe jo në datë 6.3.2023 si është hedhur në sistem). Bashkëlidhur në cilësinë e provës kanë dërguar edhe njoftimin e rendit të ditës për zhvillimin e aktivitetit”*. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së duke qenë se kemi të bëjmë me një gabim material. Në këto kushte, kur veprimtaria është raportuar brenda afatit ligjor të raportimit, nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

7. **Bashkia Tiranë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Inagurim godina 18 Rezidenca Studentore 1”*, raportuar në datë 29.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.3.2023.
- Aktivitet *“Tirana, Qyteti i Mikpritjes”* Takimi i dizajnërve për Tirana Mice (Takim mes profesionistëve të dizajnit dhe studentëve të kësaj fushe, për të diskutuar rreth industries së dizajnit dhe komunikimit të imazhit, në lidhje me brandimin e turizmit MICE dhe Tiranës si kryeqytet), raportuar në datë 29.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.3.2023.
- Aktivitet *“Takim Kryetari i Bashkisë së Bergamo-s: Giorgio Gori”*, raportuar në datë 29.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 3.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në raportim të ndërfaqes dhe nga rrethanat dhe faktet, rezulton se Bashkia Tiranë ka sqaruar nëpërmjet email – it datë 4.4.2023, se *“kemi të bëjmë me një gabim gjatë hedhjes në ndërfaqen e raportimeve, për shkak të ndryshimit të muajit pasardhës (muaji prill)”*.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së duke qenë se kemi të bëjmë me nje gabim material. Në këto kushte, kur veprimtaria është raportuar brenda afatit ligjor të raportimit, nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

8. **Bashkia Korçë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet *“Kryetari i bashkisë do të zhvillojë një takim me gratë e fshatit Voskop.”*, raportuar në datë 27.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.3.2023.
- Aktivitet *“Bashkia Korçë në kuadër te 2 Prillit- Ditës Botërore të Autizmit do të zhvillojë një fushatë ndërgjegjësuese në të cilën do të marrë pjesë edhe kryetari i bashkisë, Z.Sotiraq Filo.”*, raportuar në datë 27.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.3.2023.
- Aktivitet *“Kryetari i bashkisë është ftuar të marrë pjesë në koncertin e Ansambllit të Harqeve”*, raportuar në datë 30.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 1.4.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në raportim të ndërfaqes dhe nga rrethanat dhe faktet, rezulton se Bashkia Korçë ka sqaruar nëpërmjet

email – eve të datës 4.4.2023, 27.3.2023 dhe 30.3.2023, se “për aktivitetin takim me gratë e fshatit Voskop është raportuar dy herë në datë 27.3.2023 (datë e saktë zhvillimi datë 1.4.2023) për shkak të marrjes së datës gabim në ndërfaqen e KQZ . Aktiviteti fushatë ndërgjegjësuese në kuadër të Ditës Botërore të Autizmit, nuk mund të zbatonim afatin ligjor sepse për shkak të kushteve të motit nuk ishte vendosur data e saktë e zhvillimit. Aktiviteti pjesëmarrje në koncertin e Ansambllit të Harqeve, është raportuar në momentin kur ka ardhur ftesa.”

Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se për aktivitetin e parë “Kryetari i bashkisë do të zhvillojë një takim me gratë e fshatit Voskop” mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së duke qenë se kemi të bëjmë me nje gabim material. Në këto kushte, kur veprimtaria është raportuar brenda afatit ligjor të raportimit, nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

Lidhur me aktivitetin “Bashkia Korçë në kuadër të 2 Prillit- Ditës Botërore të Autizmit do të zhvillojë një fushatë ndërgjegjësuese në të cilën do të marrë pjesë edhe kryetari i bashkisë, Z.Sotiraq Filo.”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nisur nga natyra sensitive dhe emergjente e këtij aktiviteti, marrë parasysh edhe justifikimin e vonesës për shkak të kushteve të motit, nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

Lidhur me aktivitetin e tretë “Kryetari i bashkisë është ftuar të marrë pjesë në koncertin e Ansambllit të Harqeve”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve, rezulton se Bashkia Korçë nuk ka pasur mundësi të respektojë afatin ligjor për të raportuar për këtë aktivitet për shkak se ndodhet në cilësinë e të ftuarit. Sipas nenit 92, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kanë detyrimin për të raportuar në KQZ, të gjitha institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë veprimtari me karakter publik, në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.

9. **Bashkia Kurbin** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet “Inspektim i punimeve të Objektivit “Rrugë” Mal Milot”, raportuar në datë 30.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 15.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në raportim të ndërfaqes dhe nga rrethanat dhe faktet, rezulton se Bashkia Kurbin ka sqaruar nëpërmjet email – it datë 3.4.2023 dhe shkresës me nr. 1858 prot., datë 3.4.2023 se “nga ana jonë është bërë një lapsus dhe nga pakujdesia raportimi është kryer për një datë më të hershme , pasi gjatë raportimit kemi dashur të shënojmë datën 15.4.2023. Sqarojmë se kjo veprimtari nuk është zhvilluar si inspektim, pasi është parashikuar nga ana jonë të realizohet me datë

15.4.2023 dhe personi përgjegjës do ta publikojë përsëri në ndërfaqen e raportimeve duke respektuar afatin e parashikuar në ligj. "Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton gabimet njerëzore që mund të ndodhin gjatë hedhjes së të dhënave në sistemin e ndërfaqes të raportimeve të KQZ – së duke qenë se kemi të bëjmë me një gabim material. Në këto kushte, kur veprimtaria është raportuar brenda afatit ligjor të raportimit, nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

10. **Bashkia Tepelenë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- Aktivitet "*Homazh në laipdarin e rexhinit në Njesinë Administrative Kurvelesh*", raportuar në datë 27.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 27.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve, rezulton se nisur nga natyra e aktivitetit *Homazh në laipdarin e rexhinit në Njesinë Administrative Kurvelesh* dhe nga të dhënat e paraqitura se aktiviteti nuk do të jetë i hapur për publikun dhe pa pjesëmarrjen e medias, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se përbën veprimtari administrative që lidhet me veprimtarinë funksionale të institucionit.

11. **Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Pogradec.** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si vijon:

1. Aktivitet "*Konkurs Interpretuesi dhe shkrimi më i mirë në Rang ZVAP.*", raportuar në datë 28.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 31.3.2023.
2. Aktivitet "*Tradita dhe Folklori Jonë*", raportuar në datë 29.3.2023 dhe datë zhvillimi të aktivitetit 30.3.2023.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me të dhënat e paraqitura në ndërfaqen e raportimeve, rezulton se nisur nga natyra e aktiviteteve *Konkurs Interpretuesi dhe shkrimi më i mirë në Rang ZVAP dhe Tradita dhe Folklori Jonë*, vlerëson se përbëjnë veprimtari administrative që lidhen me veprimtarinë funksionale të institucionit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOS:

1. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
2. Pushimin e procedimit administrativ ndaj institucioneve si vijon:
 - a) Ministria e Financës dhe Ekonomisë,
 - b) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit,
 - c) Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes,
 - ç) Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin,
 - d) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale IDP,
 - dh) Prefekti i Qarkut Shkodër,
 - e) Bashkia Tiranë,
 - ë) Bashkia Korçë,
 - f) Bashkia Kurbin,
 - g) Bashkia Tepelenë,
 - gj) Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Pogradec,
3. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI